







PHILIPS

S9000 series



PHILIPS





Shqip 6

Përmbajtja

Përshkrim i përgjithshëm _____	7
Hyrje - identifikimi i makinës së rrojës _____	9
Fig. A _____	10
Fig. B _____	11
Informacion i rëndësishëm sigurie _____	12
Çfarë nënkuptojnë ikonat në ekran? (Fig. A) _____	16
Çfarë nënkuptojnë ikonat në ekran? (Fig. B) _____	18
Menyja kryesore (fig. A) _____	20
Menyja kryesore (fig. B) _____	21
Si mund ta lidh makinën e rrojës me telefonin inteligjent? (Fig. A) _____	23
Si mund ta lidh makinën e rrojës me telefonin inteligjent? (Fig. B) _____	25
Çfarë po më tregon makina e rrojës? (Fig. A) _____	28
Çfarë po më tregon makina e rrojës? (Fig. B) _____	31
Si mund ta karikoj pajisjen time? _____	32
Si mund ta përdor pajisjen dhe shtojcat? _____	34
Si mund ta pastroj pajisjen dhe shtojcat? _____	39
Mbajtja _____	46
Si mund t'i ndërroj kokat e rrojës? _____	47
Porositja e aksesorëve _____	48
Diagnostikimi _____	48
Udhëzime të mëtejshme _____	52
Riciklimi _____	52
Markat tregtare _____	53

Përshkrim i përgjithshëm

- 1 Makina e shkurtimit që ngrihet lart
- 2 Çelësi rrëshqitës i makinës së shkurtimit
- 3 Njësia e rrojës
- 4 Butoni i lëshimit i njësisë së rrojës
- 5 Tasti ndezje/fikje
- 6 Butoni i menysë
- 7 Fole për fishë të vogël
- 8 Baza e ngarkimit
- 9 Ushqyesi
- 10 Fisha e vogël
- 11 Kapaku mbrojtës
- 12 Çanta
- 13 Kutia e kapsulës për pastrim të shpejtë Philips
- 14 Kapsula për pastrim të shpejtë
- 15 Furça e pastrimit
- 16 Cilësimet e gjatësisë
- 17 Shtojca e modeluesit të mjekrës me ngërthim
- 18 Krehër për shtojcën e modeluesit të mjekrës
- 19 Mbajtësja e shtojcës
- 20 Shtojca e furçës pastruese me ngërthim

Shënim: Aksesorët e dhënë mund të ndryshojnë sipas produkteve të ndryshme. Kutia tregon aksesorët që vijnë me pajisjen.

					
S9931/20	✓				
S9932/20	✓				
S9933/50		✓	✓		
S9935/50		✓	✓		
S9936/55		✓	✓	✓	
S9982/50		✓	✓		
S9982/54		✓	✓	✓	
S9982/55		✓	✓	✓	
S9982/59		✓	✓	✓	✓
S9983/95			✓		
S9985/50		✓	✓		
S9985/59		✓	✓	✓	✓
S9985/67		✓	✓	✓	
S9985/84		✓	✓		
S9986/50		✓	✓		
S9986/55		✓	✓	✓	
S9986/58		✓	✓	✓	✓
S9986/59		✓	✓	✓	✓
S9986/63		✓	✓	✓	
S9987/50		✓	✓		
S9987/54		✓	✓	✓	
S9987/55		✓	✓	✓	
S9987/59		✓	✓	✓	✓
S9987/68		✓	✓	✓	✓
S9987/85		✓	✓	✓	

Hyrje - identifikimi i makinës së rrojës

Ju përgëzojmë për blerjen tuaj dhe mirë se vini në "Philips"! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron "Philips", regjistroni produktin në **www.philips.com/welcome** ose nëpërmjet aplikacionit.

Ky manual përdorimi përmban informacione rreth dy versioneve të makinës së rrojës S9000. Fig. A dhe fig. B ju ndihmojnë të identifikoni se cilin version keni.

Fig. A





Fig. B



MODEL: SXXXX
XXXXXXXX123 /B

Informacion i rëndësishëm sigurie

Përdoreni produktin vetëm për qëllimin e synuar. Lexojeni me kujdes këtë informacion të rëndësishëm përpara përdorimit të produktit, baterive dhe aksesoreve të tij dhe ruajeni për referencë në të ardhmen. Keqpërdorimi mund të shkaktojë rrezik ose lëndime të rënda. Aksesorët e dhënë mund të ndryshojnë sipas produkteve të ndryshme.

Paralajmërim



- Mbajeni të thatë ushqyesin dhe bazën e karikimit.



- Kjo makinë rroje është rezistente ndaj ujit. Është e përshtatshme për përdorim në banjë ose dush dhe për t'u pastruar në ujin e rubinetit. Për arsye sigurie, makina e rrojës mund të përdoret vetëm pa kordon.
- Mos e modifikoni ushqyesin.
- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë 8 vjeç e lart dhe nga persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijore ose mendore ose me mungesë përvojë e njohurish, nëse mbikëqyren apo udhëzohen për ta përdorur pajisjen në mënyrë të sigurt dhe nëse i kuptojnë rreziqet që paraqiten. Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhet të bëhet nga fëmijët pa mbikëqyrje.
- Hiqeni pajisjen nga priza përpara se ta pastroni me ujë.
- Mos e përdorni pajisjen nëse është dëmtuar. Ndërrojin pjesët e dëmtuara me pjesë të reja "Philips".
- Përdorni vetëm ujë të ftohtë ose të vakët për ta pastruar pajisjen.
- Për arsye higjienike, pajisja duhet të përdoret vetëm nga një person.

- Mos përdorni asnjëherë ajër të kompresuar, sfungjerë pastrimi, solucione gërryese pastrimi ose lëngje agresive për të pastruar pajisjen.
- Për të parandaluar rrjedhjen, vendoseni sistemin e pastrimit gjithmonë në një sipërfaqe të qëndrueshme, të niveluar dhe horizontale.
- Sigurohuni gjithmonë që foleja e kutisë të jetë e mbyllur përpara se të përdorni sistemin e pastrimit.
- Kur sistemi i pastrimit të jetë gati për t'u përdorur, mos e lëvizni në mënyrë që të parandalohet rrjedhja e lëngut të pastrimit.
- Kur e shpëlani makinën e rrojës, uji mund të pikojë nga hapësira, në pjesën e poshtme të saj. Kjo është normale dhe jo e rrezikshme sepse të gjitha pjesët elektronike janë të mbyllura në një njësi elektrike të izoluar brenda makinës së rrojës.
- Për të parandaluar dëmet e pariparueshme të ushqyesit, mos e përdorni brenda ose pranë prizave që kanë aromatizues elektrikë.
- Mos e përdorni furçën e pastrimit në lëkurë të dëmtuar ose të prekur nga sëmundje apo nga një iritrim i rëndë.
- Nëse merrni mjekim me bazë steroidesh, mos e përdorni furçën e pastrimit.
- Hiqni çdo pirsing, bizhuteritë, syzet etj. përpara se të përdorni pajisjen.
- Kini kujdes kur përdorni smartfonin tuaj pranë ujit dhe në mjedise me lagështirë.
- Valët e radios mund të pengojnë funksionimin e stimuluesve kardiakë dhe pajisjeve të tjera mjekësore. Konsultohuni me mjekun për këshilla dhe mbajeni pajisjen të paktën 20 cm larg.
- Niveli maksimal i zhurmës: $L_c = 69 \text{ dB(A)}$
- Përdorni vetëm aksesore ose pjesë konsumi "Philips". Përdorni vetëm ushqyesin e heqshëm HQ8505.
- Karikojeni, përdoreni dhe ruajeni produktin në temperaturë nga 5°C deri në 35°C .
- Mbajeni produktin dhe bateritë larg zjarrit dhe mos i ekspozoni ato në dritën e drejtpërdrejtë të diellit apo ndaj temperaturave të larta.

- Nëse produkti mbinxehet ose lëshon erë, ndryshon ngjyrë apo nëse karikimi zgjat më shumë se zakonisht, ndërpriteni përdorimin dhe karikimin e produktit dhe kontaktoni me "Philips".
- Mos i vendosni produktet dhe bateritë e tyre në furra me mikrovalë apo në tenxhere induksioni.
- Për të shmangur mbinxehjen e baterive ose çlirimin e substancave toksike apo të rrezikshme, mos e hapni, modifikoni, shponi, dëmtoni apo çmontoni produktin ose baterinë. Mos shkaktoni qark të shkurtër, mos i mbingarkoni dhe mos i karikoni në drejtim të kundërt bateritë.
- Nëse bateritë janë dëmtuar apo pikojnë, shmangni kontaktin me lëkurën ose sytë. Nëse ju ndodh diçka e tillë, shpëlahuni menjëherë me ujë dhe kërkonin ndihmën mjekësore.

Lëngu i kutisë së kapsulës për pastrim të shpejtë Philips

- Mbajeni larg fëmijëve.
- Mos e gëlltisni.

Fushat elektromagnetike (EMF)

Pajisja Philips është në përputhje me të gjitha standardet dhe rregulloret në fuqi për ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Direktiva për radiopajisjet

- Pajisjet e serisë S9000 janë të pajisura me Bluetooth të kategorisë 2.
- Brezi i frekuencës në të cilin funksionon Bluetooth në pajisjet e serisë S9000 është 2,4 GHz.
- Fuqia maksimale e frekuencës radio që rrezatohet në brezin e frekuencës në të cilin funksionojnë pajisjet e serisë S9000 është nën 20 dBm.
- Kjo pajisje është krijuar në mënyrë të tillë që produkti të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 10, paragrafi 2 që të mund të funksionojë në të paktën një shtet anëtar të BE-së, sipas ekзамinimit, si dhe të jetë në përputhje me nenin 10, paragrafi 10 me kusht që të mos ketë kufizime të shërbimit në të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

- Nëpërmjet këtij dokumenti, Philips deklaron se pajisjet e serisë S9000 janë në pajtim me kërkesat thelbësore dhe dispozitat përkatëse të Direktivës 2014/53/BE. Deklaratës së konformitetit mund t' referoheni në adresën www.philips.com/support.

Çfarë nënkuptojnë ikonat në ekran? (Fig. A)

- *Menyja kryesore (kur makina e rrojës është e fikur)*



*Mund të kaloni nëpër artikujt e menysë duke shtypur butonin e menysë.
Mund edhe të aktivizoni apo çaktivizoni veçori të caktuara duke shtypur gjatë.*

Ikona

Kuptimi



Menyja kryesore tregon statusin e baterisë në përqindje.



Ikona e menysë së sensorit të "Kontrollit të lëvizjes" ju tregojnë nëse lëvizja gjatë rruajtjes së fundit ishte e mirë apo duhet të përmirësohet..



Në këtë meny mund të aktivizoni siguresën për udhëtim.



Këtu, ekrani tregon se makina e rrojës nuk është çiftuar me telefonin inteligjent.



Ekrani tregon se makina e rrojës është çiftuar me telefonin inteligjent.

- *Ndezja e makinës së rrojës*



Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të ndezur makinën e rrojës.

Ikona

Kuptimi



Kur ndizni makinën e rrojës, një animacion i shkurtër me këto ikona tregon se cilin cilësim të reagimit për presionin keni aktivizuar. Mund të kaloni nëpër cilësimet e reagimit të presionit duke shtypur butonin e menysë.

- *Paralajmërimi dhe njoftime*

Ikona	Kuptimi
 	Bateria është shkarkuar pothuajse plotësisht dhe duhet të karikoni makinën e rrojës.
 	Kur hapësira ruajtëse e të dhënave është pothuajse plot, do të merrni një njoftim që ju rikujton të sinkronizoni rrujtjet. Për të parandaluar humbjen e të dhënave sinkronizoni makinën e rrojës me aplikacionin.
   	Njësia e rrojës është ndotur ose dëmtuar aq sa motori nuk mund të punojë. Pastroni mirë kokat e rrojës.
 	Po përdorni njësinë e gabuar të furnizimit. Përdorni vetëm njësinë e furnizimit (HQ8505) që ofrohet me makinën e rrojës.

- *Pastrimi i makinës së rrojës*

Ikona	Kuptimi
	Rikujtesë: pastrojeni makinën e rrojës në kapsulën për pastrim të shpejtë.
	Rikujtesë: pastroni makinën e rrojës.
 	Procesi i pastrimit është në progres dhe ekrani tregon kohën e mbetur të pastrimit në formën e një ore ose në sekonda nëse shtypni butonin e menysë.
	Procesi i pastrimit është ndërprerë.

- *Hiqeni nga priza për ta përdorur*

Ikona	Kuptimi
	Hiqeni makinën e rrojës nga priza përpara se ta përdorni.

Çfarë nënkuptojnë ikonat në ekran? (Fig. B)

- *Menyja kryesore*

	<i>Mund të kaloni nëpër artikujt e menysë duke shtypur butonin e menysë. Mund edhe të aktivizoni apo çaktivizoni veçori të caktuara duke e shtypur gjatë.</i>
--	---

Ikona	Kuptimi
	Kjo meny tregon statusin e baterisë në përqindje.
	Mund ta çaktivizoni ose ta riaktivizoni siguresën për udhëtim në këtë meny.
	Mund ta çaktivizoni ose ta riaktivizoni reagimin e unazës së dritës në këtë meny.

- *Ndezja e makinës së rrojës*

	<i>Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të ndezur makinën e rrojës.</i>
--	---

- *Bluetooth*

Ikona	Kuptimi
	Kjo ikonë tregon se makina e rrojës është çiftuar me telefonin inteligjent.



Kjo ikonë do të shfaqet pasi të shkëputni makinën e rrojës nga telefoni inteligjent.

- Paralajmërimi dhe njoftime

Ikona	Kuptimi
 	Bateria është shkarkuar pothuajse plotësisht dhe duhet të karikoni makinën e rrojës.
 	Kur hapësira ruajtëse e të dhënave është pothuajse plot, do të merrni një njoftim që ju rikujton të sinkronizoni rrujtjet. Për të parandaluar humbjen e të dhënave, sinkronizoni makinën e rrojës me aplikacionin.
   	Njësia e rrojës është ndotur ose dëmtuar aq sa motori nuk mund të punojë. Pastroni mirë kokat e rrojës.
 	Po përdorni kordonin elektrik të gabuar. Përdorni vetëm kordonin elektrik që ofrohet me makinën e rrojës.

- Pastrimi i makinës së rrojës

Ikona	Kuptimi
	Rikujtesë: pastrojeni makinën e rrojës në kapsulën për pastrim të shpejtë.
	Rikujtesë: pastroni makinën e rrojës.
 	Procesi i pastrimit është në progres dhe ekrani tregon kohën e mbetur të pastrimit në formën e një ore ose në sekonda nëse shtypni butonin e menysë.



Procesi i pastrimit është ndërprerë.

- *Hiqeni nga priza për ta përdorur*

Ikona

Kuptimi



Hiqeni makinën e rrojës nga priza përpara se ta përdorni.

Menyja kryesore (fig. A)

Kur makina e rrojës është e fikur, mund të kaloni gjithashtu përmes katër funksioneve të menysë duke shtypur butonin e menysë.

- **Karikimi i mbetur i baterisë**

Ky artikull i menysë tregon karikimin e mbetur të baterisë.



- **Sensori i "Kontrollit të lëvizjes"**

Ky artikull i menysë tregon komentin për presionin nga rrualtja e fundit.



- **Siguresa për udhëtim**

Nga ky artikull i menysë, mund ta bllokoni dhe zhblokoni makinën e rrojës duke shtypur dhe mbajtur shtypur butonin e menysë për 3 sekonda. Kur të udhëtoni, mund ta bllokoni makinën e rrojës për të parandaluar ndezjen aksidentale. Kur aktivizohet siguresa për udhëtim, Bluetooth do të çaktivizohet automatikisht dhe makina juaj e rrojës do të jetë në modalitetin e kursimit të energjisë.





- Bluetooth

Nga ky artikull i menysë, mund të çiftoni makinën e rrojës me telefonin inteligjent.

Për informacione rreth përfitimeve të çiftimit të makinës së rrojës me telefonin inteligjent, shihni "Përfitimet e lidhjes së makinës së rrojës me aplikacionin".

Shënim: Sigurohuni që telefoni inteligjent ka **Bluetooth® 4.2** e lart.

Makina e rrojës është e pajisur me **Bluetooth® 4.2** e lart për t'u lidhur me aplikacionin. Pasi të keni çiftuar makinën e rrojës me telefonin inteligjent, Bluetooth do të aktivizohet automatikisht në makinën e rrojës, edhe nëse kjo e fundit është e fikur. Kjo lejon që të dhënat e rruajtjes të sinkronizohen më vonë, kështu që nuk ju duhet ta merrni telefonin inteligjent me vete kur rruheni.

Shënim: Mund ta çaktivizoni Bluetooth në makinën e rrojës duke aktivizuar siguresën për udhëtim.

Menyja kryesore (fig. B)

Mund të kaloni nëpër funksionet e menysë duke shtypur butonin e menysë.

Karikimi i mbetur i baterisë

Ky artikull i menysë tregon karikimin e mbetur të baterisë.



Reagimi pas rruajtjes



Shënim: Kjo meny shfaqet vetëm pasi të aktivizoni këtë veçori nëpërmjet cilësimeve të aplikacionit.

Mund të optimizoni përvojën tuaj të rruajtjes duke kryer lëvizjen dhe duke ushtruar sasinë e duhur të presionit. Ky artikull tregon **vlerësimin me yje** të rruajtjes së fundit. Ai tregon nëse presioni dhe lëvizja e aplikuar gjatë rruajtjes ishte e mirë ose nëse mund të përmirësohet.

Siguresa për udhëtim



Kur të udhëtoni, mund ta bllokoni makinën e rrojës për të parandaluar ndezjen aksidentale. Në këtë meny, shtypni dhe mbani shtypur butonin e menysë për 3 sekonda për të kyçur ose për të shkyçur makinën e rrojës. Kur aktivizohet siguresa për udhëtim, Bluetooth do të çaktivizohet automatikisht dhe makina juaj e rrojës do të jetë në modalitetin e kursimit të energjisë.

Ndezja/fikja e unazës së dritës



Gjatë rruahtjes, do të merrni koment për nivelin e presionit që po ushtroni nëpërmjet unazës së dritës në pjesën e sipërme të dorezës së makinës së rrojës. Unaza e dritës është aktive në mënyrë të parazgjedhur. Mund ta çaktivizoni ose ta riaktivizoni atë.

Për të **çaktivizuar** reagimin e unazës së dritës,

- 1 Kaloni nëpër artikujt e menysë duke shtypur butonin e menysë derisa të arrini në menynë "Drita e ndezur".
- 2 Ndërkohë që jeni në menynë "Drita e ndezur", shtypni dhe mbani shtypur butonin e menysë për 3 sekonda derisa të shihni ekranin "Drita e ndezur".

Për të **riaktivizuar** reagimin e unazës së dritës,

- 1 Kaloni nëpër artikujt e menysë duke shtypur butonin e menysë derisa të arrini në menynë "Drita e fikur".
- 2 Ndërkohë që jeni në menynë "Drita e fikur", shtypni dhe mbani shtypur butonin e menysë për 3 sekonda derisa të shihni ekranin "Drita e ndezur".

Shënim: Reagimi i unazës së dritës disponohet vetëm kur njësia e rrojës është vendosur në dorezë.

Bluetooth



Shënim: Menyja e "Bluetooth" shfaqet vetëm kur makina e rrojës është çiftuar me telefonin inteligjent.

Këtu mund të shkëputni makinën e rrojës dhe telefonin inteligjent. Për të mësuar rreth përfitimeve të çiftimit të makinës së rrojës me telefonin inteligjent, shihni "Përfitimet e lidhjes së makinës së rrojës me aplikacionin".

Shënim: Sigurohuni që telefoni inteligjent ka **Bluetooth® 4.2** e lart.

Makina e rojës është e pajisur me **Bluetooth®** 4.2 e lart për t'u lidhur me aplikacionin. Pasi të keni çiftuar makinën e rojës me telefonin inteligjent, Bluetooth do të aktivizohet automatikisht në makinën e rojës, edhe nëse kjo e fundit është e fikur. Kjo lejon që të dhënat e rrugës të sinkronizohen më vonë, kështu që nuk ju duhet ta merrni telefonin inteligjent me vete kur rruheni.

Shënim: Mund ta çaktivizoni Bluetooth në makinën e rojës duke aktivizuar siguresën për udhëtim.

Si mund ta lidh makinën e rojës me telefonin inteligjent? (Fig. A)

Përfitimet e lidhjes së makinës së rojës me aplikacionin

Mund ta përdorni aplikacionin:

- Për të marrë reagime dhe udhëzime në kohë reale për lëvizjen dhe presionin,
- Për të aktivizuar dhe për të personalizuar reagimin pas rrugës,
- Për të sinkronizuar të dhënat e rrugës dhe për të gjurmuar historikun e rrugës,
- Për të përmirësuar rutinën e rrugës dhe për të reduktuar problemet e lëkurës nga rrugë,
- Për të marrë këshilla dhe rekomandime të personalizuara për stilin.

Çiftoni makinën e rojës me telefonin inteligjent




Aplikacioni përputhet me një gamë të gjerë të telefonave inteligjentë iPhone dhe Android™.

Më shumë informacion disponohet në

www.philips.com/MyShaver9000-app.

1 Shkarkoni aplikacionin.



- 2 Sigurohuni që Bluetooth të jetë aktivizuar në telefonin tuaj inteligjent.
- 3 Ndizni makinën e rrojës për të aktivizuar Bluetooth.
- 4 Hapni aplikacionin dhe ndiqni udhëzimet për të nisur procesin e çiftimit.
- 5 Pasi të jenë çiftuar, makina e rrojës do të lidhet automatikisht me aplikacionin kur hapet aplikacioni dhe të aktivizohet Bluetooth në telefon.

Sinkronizoni rruajtjet

Kjo makinë rroje ruan të dhënat e rruajtjes në mënyrë që të mos e merrni telefonin inteligjent kur rruheni ose kur dëshironi të kontrolloni të dhënat e rruajtjes në një fazë të mëvonshme.

Kur hapësira ruajtëse e të dhënave është pothuajse plot, do të merrni një njoftim që ju rikujton të sinkronizoni rruajtjet. Për të parandaluar humbjen e të dhënave sinkronizoni makinën e rrojës me aplikacionin.

- 1 Sigurohuni që telefoni të jetë pranë makinës së rrojës dhe hapni aplikacionin.
- 2 Aplikacioni lidhet automatikisht dhe sinkronizon rruajtjet tuaja të fundit.

Shçiftoni makinën e rrojës me telefonin inteligjent

Makinën e rrojës mund ta çiftoni vetëm me një telefon inteligjent njëkohësisht. Ndiqni këto hapa për ta shkëputur makinën e rrojës nga telefoni inteligjent (p.sh. kur merrni një telefon të ri inteligjent):

- **Fillimisht, shkëputni makinën e rrojës.**



- 1 Kaloni nëpër artikujt e menysë duke shtypur butonin e menysë derisa të arrini në menyë "Bluetooth"..



- 2 Shtypni dhe mbani shtypur butonin e menysë derisa të shfaqet zgjedhja me kryq dhe shenjë miratimi.



- 3 Zgjidhni shenjën e miratimit duke shtypur sërish butonin e menysë për të shëfistuar makinën e rrojës.

Shënim: Kur makina e rrojës të jetë çiftuar me sukses, në dorezën e saj do të shfaqet ikona e "Bluetooth".

Shënim: Kur të dëshironi ta çiftoni sërish makinën e rrojës me telefonin inteligjent, fillimisht sigurohuni që të mos jenë çiftuar të dyja.

- **Më pas, shkëputni telefonin inteligjent.**

- 1 Shkoni te cilësimet në telefonin inteligjent dhe zgjidhni Bluetooth.
- 2 Prekni emrin e makinës së rrojës.
- 3 Prekni "harro" ose "shëfisto".

Shënim: Procedura e shëftimit mund të ndryshojë në varësi të telefonit inteligjent. Kontrolloni manualin e telefonit inteligjent për më tepër informacion.

Si mund ta lidh makinën e rrojës me telefonin inteligjent? (Fig. B)

Përfitimet e lidhjes së makinës së rrojës me aplikacionin

Mund ta përdorni aplikacionin:

- Për të marrë reagime dhe udhëzime në kohë reale për lëvizjen dhe presionin,
- Për të aktivizuar dhe për të personalizuar reagimin pas rruajtjes,

- Për të sinkronizuar të dhënat e rruajtjes dhe për të gjurmuar historikun e rruajtjes,
- Për të përmirësuar rutinën e rruajtjes dhe për të reduktuar problemet e lëkurës nga rruajtja,
- Për të marrë këshilla dhe rekomandime të personalizuar për stilin.

Çiftoni makinën e rrojës me telefonin inteligjent



Aplikacioni përputhet me një gamë të gjerë të telefonave inteligjentë iPhone dhe Android™.

Më shumë informacion disponohet në **www.philips.com/MyShaver9000-app**.

1 Shkarkoni aplikacionin.


2 Sigurohuni që Bluetooth të jetë aktivizuar në telefonin tuaj inteligjent.

3 Ndizni makinën e rrojës për të aktivizuar Bluetooth.

4 Hapni aplikacionin dhe ndiqni udhëzimet për të nisur procesin e çiftimit.

5 Pasi të jenë çiftuar, makina e rrojës do të lidhet automatikisht me aplikacionin kur hapet aplikacioni dhe të aktivizohet Bluetooth në telefon.

Shënim: Kur makina e rrojës është çiftuar me telefonin inteligjent, menyja e "Bluetooth" shfaqet si artikull i ri.



Sinkronizoni rruajtjet

Kjo makinë rroje ruan të dhënat e rruajtjes në mënyrë që të mos e merrni telefonin inteligjent kur rruheni ose kur dëshironi të kontrolloni të dhënat e rruajtjes në një fazë të mëvonshme.

Kur hapësira ruajtëse e të dhënave është pothuajse plot, do të merrni një njoftim që ju rikujton të sinkronizoni rruajtjet. Për të parandaluar humbjen e të dhënave, sinkronizoni makinën e rrojës me aplikacionin.

- 1 Sigurohuni që telefoni të jetë pranë makinës së rrojës dhe hapni aplikacionin.
- 2 Aplikacioni lidhet automatikisht dhe sinkronizon rruajtjet tuaja të fundit.

Shçiftoni makinën e rrojës me telefonin inteligjent

Makinën e rrojës mund ta çiftoni vetëm me një telefon inteligjent njëkohësisht. Ndiqni këto hapa për ta shkëputur makinën e rrojës nga telefoni inteligjent (p.sh. kur merrni një telefon të ri inteligjent):

- **Fillimisht, shkëputni makinën e rrojës.**

- 1 Kaloni nëpër artikujt e menysë duke shtypur butonin e menysë derisa të arrini në menyne "Bluetooth".



- 2 Shtypni dhe mbani shtypur butonin e menysë derisa të shfaqet zgjedhja me kryq dhe shenjë miratimi.



- 3 Zgjidhni shenjen e miratimit duke shtypur sërish butonin e menysë për të shçiftuar makinën e rrojës.

Shënim: Kur makina e rrojës është çiftuar me telefonin inteligjent, menyja e "Bluetooth" shfaqet si artikull i ri. Kur të jetë e shkëputur, do të shfaqet kjo meny.

Shënim: Kur makina e rrojës të jetë shkëputur me sukses, në ekranin e saj do të shfaqet për një kohë të shkurtër ikona e "Bluetooth".

Shënim: Kur të dëshironi ta çiftoni sërish makinën e rrojës me telefonin inteligjent, fillimisht sigurohuni që të mos jenë çiftuar të dyja.

- **Më pas, shkëputni telefonin inteligjent.**



- 1 Shkoni te cilësimet në telefonin inteligjent dhe zgjidhni Bluetooth.
- 2 Prekni emrin e makinës së rrojës.
- 3 Prekni "harro" ose "shçifto".

Shënim: Procedura e shçiftimit mund të ndryshojë në varësi të telefonit inteligjent. Kontrolloni manualin e telefonit inteligjent për më tepër informacion.

Çfarë po më tregon makina e rrojës? (Fig. A)

Reagimi i unazës së dritës

Gjatë rruajtjes, do të merrni koment për nivelin e presionit që po ushtroni nëpërmjet unazës së dritës në pjesën e sipërme të dorezës së makinës së rrojës. Unaza e dritës në dorezë ndizet me ngjyra të ndryshme gjatë rruajtjes për t'ju dhënë koment për nivelin e presionit po ushtroni. Këto janë cilësimet e parazgjedhura:



- Kur nuk ushtroni mjaftueshëm presion, unaza e dritës ndizet në ngjyrë **blu**.



- Kur ushtroni sasinë e duhur të presionit, unaza e dritës ndizet në ngjyrë **të gjelbër**.



- Kur ushtroni shumë presion, unaza e dritës ndizet në ngjyrë **portokalli**.

Kur makina e rrojës është e ndezur, mund të personalizoni llojin e komentit që merrni për presionin.

- 1 Ndizni makinën e rrojës.





- 2 Shtypni butonin e menysë për të ndryshuar opsionet e komentit për presionin. Tabela më poshtë tregon se çfarë komenti për presionin do të merrni me secilin opsion.

	Po ushtrohet shumë pak presion	Po ushtrohet sasia e duhur e presionit	Po ushtrohet shumë presion
Koment për presionin e plotë 	 blu	 e gjelbër	 portokalli
Koment për presionin e pjesshëm 	Nuk ka koment	Nuk ka koment	 portokalli
Komenti kur nuk ka presion 	Nuk ka koment	Nuk ka koment	Nuk ka koment

Shënim: Shënim: Reagimi i unazës së dritës disponohet vetëm kur njësia e rrojës është vendosur në dorezë.

Kur modeluesi i mjekrës ose furça e pastrimit është vendosur në dorezë, komenti për lëvizjen dhe presionin çaktivizohet automatikisht.

Reagimi pas rruajtjes

Shënim: Kjo veçori aktivizohet nëpërmjet cilësimeve të aplikacionit.

Mund të optimizoni përvojën tuaj të rruajtjes duke kryer lëvizjen dhe duke ushtruar sasinë e duhur të presionit. Pasi të aktivizohet kjo veçori, makina e rrojës ju jep

reagim menjëherë pasi të rruheni dhe të fikni makinën e rrojës.

Reagimi i sensorit të "Mbikëqyrësit të presionit"

Kur presioni i rruajtjes mund të përmirësohet, ikona e sensorit të "Mbikëqyrësit të presionit" shfaqet me një pikëçuditje.

- Presioni që keni ushtruar gjatë rruajtjes ishte shumë i lartë.



- Presioni që keni ushtruar gjatë rruajtjes ishte shumë i ulët.



Reagimi i sensorit të "Kontrollit të lëvizjes"

- Kur lëvizja e rruajtjes mund të përmirësohet, ikona e sensorit të "Kontrollit të lëvizjes" shfaqet me një pikëçuditje.



- Kur presioni dhe lëvizja e ushtruar gjatë rruajtjes janë të përkryera, të dyja ikonat shfaqen me një shenjë miratimi.

Çfarë po më tregon makina e rrojës? (Fig. B)

Reagimi i unazës së dritës

Gjatë rruajtjes, do të merrni koment për nivelin e presionit që po ushtroni nëpërmjet unazës së dritës në pjesën e sipërme të dorezës së makinës së rrojës. Unaza e dritës në dorezë ndizet në ngjyra të ndryshme gjatë rruajtjes për t'ju dhënë reagim për nivelin e presionit që po ushtroni. Kjo veçori është aktive në mënyrë të parazgjedhur.



- Kur nuk ushtroni mjaftueshëm presion, unaza e dritës ndizet në ngjyrë **blu**.



- Kur ushtroni sasinë e duhur të presionit, unaza e dritës ndizet në ngjyrë **të gjelbër**.



- Kur ushtroni shumë presion, unaza e dritës ndizet në ngjyrë **portokalli**.



Mund ta çaktivizoni ose ta riaktivizoni këtë veçori te menyja "Drita e ndezur/fikur".

Shënim: Reagimi i unazës së dritës disponohet vetëm kur njësia e rrojës është vendosur në dorezë.

Reagimi pas rruajtjes

Shënim: Kjo veçori aktivizohet nëpërmjet cilësimeve të aplikacionit.

Mund të optimizoni përvojën tuaj të rruajtjes duke kryer lëvizjen dhe duke ushtruar sasinë e duhur të presionit. Makina e rrojës ju jep një **vlerësim me yje** për lëvizjen dhe presionin e aplikuar gjatë rruajtjes së fundit. Pasi kjo veçori të aktivizohet,

- Në makinën e rrojës shfaqet një artikull i menysë për reagimin pas rruajtjes.



- Pas çdo rruajtjeje, menjëherë pasi të fikni makinën e rrojës, shihni reagimin e menjëhershëm në tri mënyra alternative.
- Makina e rrojës mund të japë reagim për **presionin** e ushtruar gjatë rruajtjes së fundit.



- Makina e rrojës mund të japë edhe reagim për **lëvizjen**.



- Përndryshe, makina e rrojës mund të japë reagim për **presionin dhe lëvizjen**.



- Kur të navigoni nëpër meny më vonë, shihni vlerësimin e lëvizjes dhe të presionit të rruajtjes së fundit në artikullin e ri të menysë.

Si mund ta karikoj pajisjen time?


Shënim: Pajisja është rezistente ndaj ujit. Është e përshtatshme për përdorim në banjë ose dush dhe për t'u pastruar në ujin e rubinetit. Për arsye sigurie, pajisja mund të përdoret vetëm pa kordon.

- Karikojeni pajisjen përpara se ta përdorni për herë të parë dhe kur karikimi i mbetur i baterisë të tregojë që bateria është pothuajse e shkarkuar.
- Ngarkimi zgjat rreth 1 orë.

- Karikimi i shpejtë: Pas rreth 5 minutave në karikim, bateria ka energji të mjaftueshme për një rruahtje të plotë. Kur bateria karikohet në 10 %, mund të kryeni një rruahtje të plotë.
- Kur pajisja është plotësisht e karikuar, ajo mund të përdoret pa kordon deri në 60 minuta.

Shënim: Nuk mund ta përdorni pajisjen ndërkohë që është në karikim.

Karikimi me ushqyesin



- 1 Sigurohuni që pajisja të jetë fikur.
- 2 Futeni fishën e vogël në pajisje dhe ushqyesin në prizë.
 - Ndërkohë që pajisja karikohet, në ekran shfaqet një animacion që tregon progresin.
 - Kur pajisja të karikohet plotësisht, përqindja e baterisë tregon 100 % dhe ikona e baterisë tregon se ajo është plot.
- 3 Pas ngarkimit, hiqeni ushqyesin nga priza dhe hiqeni fishën e vogël nga pajisja.

Simboli i shkëputjes nga priza për përdorim



Simboli i "heqjes nga priza për përdorim" shfaqet për t'ju rikujtuar se duhet ta hiqni pajisjen nga priza dhe të hiqni fishën e vogël nga pajisja përpara se ta ndizni atë.

Karikimi në bazën e karikimit (vetëm modele të caktuara)



- 1 Sigurohuni që pajisja të jetë fikur.
- 2 Futni fishën e vogël në bazën e karikimit dhe ushqyesin në prizë.
- 3 Vendoseni pajisjen në bazën e karikimit.

Vetëm modele të caktuara: Unaza e dritës në pjesën e poshtme të bazës së karikimit ndizet dhe rrotullohet shpejt.

- Pas rreth 5 minutash, unaza e dritës rrotullohet më ngadalë. Tani bateria ka energji të mjaftueshme për një rruahtje të plotë.

- Teksa pajisja vazhdon të karikohet, unaza e dritës bëhet me shndritshme dhe rrotullohet më ngadalë.
- Kur pajisja karikohet plotësisht, unaza e dritës ndizet plotësisht dhe ndalon së rrotulluari.

Si mund ta përdor pajisjen dhe shtojcat?

Paralajmërim: Kontrolloni gjithmonë pajisjen dhe aksesoret përpara se t'i përdorni. Mos përdorni pajisjen apo aksesoret nëse janë të dëmtuara, sepse kjo mund të shkaktojë lëndim. Ndërrojeni gjithmonë pjesën e dëmtuar me një pjesë tjetër origjinale.

Rroja


Këtë pajisje mund ta përdorni në të thatë ose në të njomë, ose edhe në dush. Për një rruajtje të njomë, vendosni pak ujë dhe shkumë ose xhel rroje në lëkurën tuaj dhe shpëlani kokat e rrojës me ujë të ngrohtë në rubinet përpara se të ndiqni hapat e mëposhtëm.

- 1 Ndizeni pajisjen.
- 2 Lëvizini kokat e rrojës në lëkurë me lëvizje rrethore për të kapur të gjitha qimet që rriten në drejtime të ndryshme. Sigurohuni që çdo kokë rroje të jetë plotësisht në kontakt me lëkurën. Lëvizeni butësisht në lëkurë për rrojë komode dhe të lëmuar.

Shënim: Mos e shtyni fort, pasi kjo mund të shkaktojë irritim të lëkurës.

Shënim: Nëse po rruheni me shkumë ose xhel rroje, shpëlani rregullisht njësinë e rrojës gjatë rruajtjes për t'u siguruar që rrëshqet butësisht në lëkurë.





- 3** Përdorni anën e ngushtë të njësisë së rrojës për t'u rrojtur në zona që janë të vështira për t'u arritur të tilla si përgjatë nofullës dhe nën hundë.

- 4** Fikeni dhe pastrojeni pajisjen pas çdo përdorimi.

Shënim: Sigurohuni që ta keni shpëlarë të gjithë shkumën ose xhelin e rrojës nga pajisja.

Periudha e përshtatjes së lëkurës

Rruajtjet e para mund të mos sjellin rezultatin që prisni dhe lëkura madje mund të irritohet pak. Kjo është normale. Lëkurës i duhet kohë për t'u përshtatur me sistemet e reja të rrojës.

Ndiqui këshillat e dhëna nga aplikacioni dhe të rruhuni rregullisht (të paktën 3 herë në javë) me këtë makinë rroje për një periudhë prej 3-4 javësh për të lejuar lëkurën të përshtatet me makinën e re të rrojës.

Rikujtesa e pastrimit




Kur të fikni pajisjen, do të shfaqet rikujtesa e pastrimit për t'ju rikujtuar të pastroni pajisjen.

- Pastroni pajisjen dhe shtojcat pas çdo përdorimi për të parandaluar bllokimet dhe dëmtimet.
- Pastroni mirë kokat e rrojës njëherë në muaj ose kur pajisja nuk rruan aq mirë sa më parë.

Shkurtimi

Makinën e shkurtimit mund ta përdorni për të rregulluar favoritet dhe mustaqet.



- 1 Shtyni poshtë këmbëzën rrëshqitëse të makinës së shkurtimit për të hapur makinën e shkurtimit.
- 2 Ndizeni pajisjen.



- 3 Mbajeni makinën e shkurtimit pingul me lëkurën dhe lëvizeni pajisjen për poshtë duke e shtyrë lehtë.



- 4 Ju mund të përdorni makinën e shkurtimit edhe nën hundë.
- 5 Fikni pajisjen dhe pastroni makinën e shkurtimit pas çdo përdorimi për të parandaluar bllokimet dhe dëmtimet.
- 6 Mbyllni makinën e shkurtimit.

Përdorimi i shtojcave me ngërthim

Shënim: Aksesorët e dhënë mund të ndryshojnë sipas produkteve të ndryshme. Kutia tregon aksesorët që vijnë me produktin tuaj.

Shënim: Makina e rrojës jep reagim ndaj presionit dhe lëvizjes vetëm kur njësia e rrualtjes është vendosur në dorezë.

Përdorimi i shtojcës me ngërthim të modeluesit të mjekrës me krehër

Mund të përdorni shtojcën e modeluesit të mjekrës me krehurin të montuar për të modeluar mjekrën me një cilësim të fiksuar ose me cilësime të ndryshme gjatësie. Gjithashtu, për rrojë më komode, mund ta përdorni për të shkurtuar paraprakisht qimet e gjata para rrojës. Cilësimet e gjatësisë së qimeve në shtojcën e modeluesit të mjekrës përkohë me gjatësinë e mbetur të qimeve pas prerjes dhe ndryshojnë nga 1 deri në 5 mm.




- 1 Rrotulloni kokën e rrojës ose shtojcën tjetër për ta hequr atë nga doreza dhe shtyjeni shtojcën e modeluesit të mjekrës në dorezë.



- 2 Rrëshqiteni krehrin direkt në kanalet udhëzuese në dy anët e shtojcës së modeluesit të mjekrës.




- 3 Shtypni zgjedhësin e gjatësisë dhe pastaj shtyjeni në të majtë ose në të djathtë për të zgjedhur cilësimin e dëshiruar të gjatësisë së qimeve.
- 4 Ndizeni pajisjen.



- 5 Lëvizeni për lart pajisjen duke e shtyrë lehtë. Sigurohuni që pjesa e përparme e krehrit është në kontakt të plotë me lëkurën.
- 6 Fikeni pajisjen dhe pastrojeni shtojcën pas përdorimit.

Përdorimi i shtojcës së modeluesit të mjekrës me ngërthim pa krehër

Mund ta përdorni shtojcën e modeluesit të mjekrës pa krehrin për të konturuar mjekrën, mustaqet, favoritet ose vijën e qafës në gjatësi 0,5 mm.



- 1 Hiqni krehrin nga shtojca e modeluesit të mjekrës.

Shënim: Kapeni krehrin në qendër për ta hequr nga shtojca e modeluesit të mjekrës. Mos tërhiqni nga anët e krehrit.

- 2 Ndizeni pajisjen.



- 3 Mbajeni shtojcën e modeluesit të mjekrës pingul me lëkurën dhe lëvizeni pajisjen për poshtë duke e shtyrë lehtë.
- 4 Fikeni pajisjen dhe pastrojeni shtojcën pas përdorimit.

Përdorimi i shtojcës së furçës pastruese

Përdorni furçën pastruese me krem pastrues të përditshëm për të hequr yndyrën dhe papastërtitë.

Ju këshillojmë ta përdorni jo më tepër se një herë në javë.

Kujdes: Mos e përdorni pajisjen mbi lëkurë të irrituar ose të dëmtuar apo mbi plagë.



- 1 Rrotulloni kokën e rrojës ose shtojcën tjetër për ta hequr atë nga doreza dhe shtyjeni shtojcën e furçës pastruese në dorezë.
- 2 Lageni furçën pastruese me ujë.

Mos e përdorni furçën pastruese të thatë, sepse mund të irritojë lëkurën.

- 3 Lageni fytyrën me ujë dhe përdorni pastrues për fytyrën.
- 4 Vendosni furçën pastruese në faqen tuaj.
- 5 Ndizeni pajisjen.
- 6 Lëvizeni furçën lehtë mbi lëkurë nga hunda në drejtim të veshit. Mos ushtroni shumë forcë. Sigurohuni që trajtimi të mbetet komod.

Mos pastroni zonën e ndjeshme përreth syve.



- 7 Pas afërsisht 20 sekondave, lëvizeni pajisjen në faqen tjetër dhe filloni të pastroni këtë anë të fytyrës.



- 8 Pas afërsisht 20 sekondave, lëvizeni pajisjen drejt ballit dhe filloni të pastroni këtë pjesë të fytyrës. Lëvizeni lehtë kokën e furçës nga e majta në të djathtë.

Ju këshillojmë të mos e teproni me pastrimin dhe të mos i pastroni zonat për më tepër se 20 sekonda.

- 9 Fikeni pajisjen dhe pastrojeni shtojcën pas përdorimit.
- 10 Pas trajtimit, shpëlani dhe thani fytyrën. Fytyra juaj është tani gati për hapin tjetër të rutinës ditore të kujdesit për lëkurën.

Si mund ta pastroj pajisjen dhe shtojcat?

Pastroni pajisjen dhe shtojcat pas çdo përdorimi për një rendiment optimal.

Pastrimi i makinës së rrojës me ujë rubineti

Pastroni makinën e rrojës pas çdo përdorimi për të parandaluar bllokimet dhe dëmtimet.

Mos e thani asnjëherë njësinë e rrojës me peshqir apo leckë, pasi mund të dëmtohen kokat e rrojës.

Kur e shpëlani njësinë e rrojës, uji mund të pikojë jashtë bazamentit të makinës së rrojës. Kjo është diçka normale.



- 1 Ndizni makinën e rrojës.
- 2 Shpëlajeni njësinë e rrojës me ujë të ngrohtë rubineti.
- 3 Fikeni makinën e rrojës. Shtypni butonin e lëshimit për të hapur njësinë e rrojës.
- 4 Shpëlani folenë e qimeve me ujë të ngrohtë rubineti.





- 5 Shpëlani mbajtësen e kokës së rrojës me ujë të ngrohtë rubineti.
- 6 Shkundni me kujdes ujin e tepërt dhe lëreni mbajtësen e kokës së rrojës të thahet plotësisht në ajër.



- 7 Mbyllni njësinë e rrojës.

Pastrimi tërësor

Ne ju këshillojmë të pastroni mirë kokat e rrojës njëherë në muaj ose kur makina e rrojës nuk rruan aq mirë sa më parë.

- 1 Sigurohuni që të jetë pajisja të jetë fikur dhe hequr nga priza.
- 2 Shtypni butonin e lëshimit në njësinë e rrojës dhe hiqni mbajtësen e kokës së rrojës nga njësia e rrojës.



- 3 Shpëlajeni folenë e qimeve dhe mbajtësen e kokës së rrojës me ujë rubineti.
- 4 Hiqni kokat e rrojës. Për udhëzime të detajuara, shikoni "Si mund t'i ndërroj kokat e rrojës?".



Shënim: Mos pastroni më shumë se një prerëse dhe një mbrojtës njëkohësisht, pasi të gjitha përputhen me kompletet e tyre. Nëse vendosni aksidentalisht një prerëse në mbrojtësin e gabuar të makinës së rrojës, mund të duhen disa javë që të rikthehet performanca optimale e rrojës.




- 5 Pastroni prerësin dhe mbrojtësen me ujë rubineti.
- 6 Shkunderi ujin e tepërt.
- 7 Rivendosni kokat e rrojës në njësinë e rrojës. Për udhëzime të detajuara, shikoni "Si mund t'i ndërroj kokat e rrojës?".
- 8 Futni kapësen e mbajtëses së kokës së rrojës në pjesën e sipërme të njësisë së rrojës dhe mbylleni atë.


Pastrimi i makinës së shkurtimit që ngrihet lart

Pastroni makinën e shkurtimit pas çdo përdorimi për të parandaluar bllokimet dhe dëmtimet.


Mos e thani kurrë elementin prerës me peshqir apo leckë, pasi mund të dëmtoni dhëmbët prerës.



- 1 Sigurohuni që të jetë pajisja të jetë fikur dhe hequr nga priza.
- 2 Shtyni poshtë këmbëzën rrëshqitëse të makinës së shkurtimit për të hapur makinën e shkurtimit që ngrihet lartë.



- 3 Ndizeni pajisjen dhe shpëlani makinën e shkurtimit që ngrihet lartë me ujë të ngrohtë.
- 4 Fikeni pajisjen pas pastrimit.
- 5 Shkunderi me kujdes ujin e tepërt dhe lëreni makinën e shkurtimit që ngrihet lart të thahet në ajër.
- 6 Mbyllni makinën e shkurtimit.



Këshillë: Për një rendiment optimal, lubrifikoni çdo gjashtë muaj dhëmbët e makinës së shkurtimit që ngrihet lartë me një pikë vaji mineral (vaji nuk përfshihet).

Pastrimi i shtojcave me ngërthim

Mos e thani kurrë makinën e shkurtimit ose shtojcat e modeluesit të mjekrës me peshqir apo lecka, pasi mund të dëmtoni dhëmbët prerës.





Aksesorët e dhënë mund të ndryshojnë sipas produkteve të ndryshme. Kutia tregon aksesorët që vijnë me produktin tuaj.

Pastrimi i shtojcës së modeluesit të mjekrës

Pastroni shtojcën e modeluesit të mjekrës pas çdo përdorimi.

- 1 Hiqni krehrin nga shtojca e modeluesit të mjekrës.

Shënim: Kapeni krehrin në qendër për ta hequr nga shtojca e modeluesit të mjekrës. Mos tërhiqni nga anët e krehrit.



- 2 Shpëlajini qimet e prera nga njësia prerëse me ujë të vakët.
- 3 Shpëlajini qimet e prera nga krehri.

- 4 Hiqni njësinë prerëse nga shtojca e modeluesit të mjekrës. Duke shtyrë njësinë prerëse nga shtojca e modeluesit të mjekrës, mund të hiqni qimet që janë grumbulluar brenda modeluesit të mjekrës. Gjithashtu, mund ta shpëlani pjesën e pasme të njësisë prerëse.

- 5 Shpëlajini qimet e prera nga shtojca e modeluesit të mjekrës.
- 6 Shkundni me kujdes ujin e tepërt dhe lëreni krehrin, njësinë prerëse dhe shtojcën e modeluesit të mjekrës të thahen para përdorimit tjetër.

Mos e thani kurrë njësinë prerëse me peshqir apo lecka, pasi mund të dëmtoni dhëmbët prerës.



- 7 Kur njësia prerëse të jetë tharë, vendoseni atë në shtojcën e modeluesit të mjekrës.




- 8 Kur krehri të jetë i thatë, rivendoseni atë në modeluesin e mjekrës.

Këshillë: Për një rendiment optimal, lubrifikoni rregullisht dhëmbët e shtojcës së modeluesit të mjekrës me një pikë vaji për makinë qepëse.

Pastrimi i shtojcës së furçës pastruese

Pastroni shtojcën e furçës pastruese pas përdorimit.



- 1 Fikeni pajisjen.
- 2 Hiqni shtojcën nga mbajtësi i shtojcave.
- 3 Pastroni mirë pjesët me ujë të ngrohtë dhe sapun.
- 4 Thajeni shtojcën me peshqir.



Si mund ta përdor kapsulën për pastrim të shpejtë?


Përgatitja e kapsulës për pastrim të shpejtë për përdorim

- 1 Rrotulloni dhe hiqni pjesën e sipërme të kapsulës për pastrim të shpejtë.
- 2 Rrotulloni dhe hiqni kutinë e kapsulës për pastrim të shpejtë.







- 3 Ngrini gjuhëzën në stamp dhe tërhiqeni atë nga cepi për të hequr vulën nga kutia e kapsulës së pastrimit e shpejtë.



- 4 Shtypni pjesëzën rrethore në dorezën e kutisë së kapsulës për pastrimin e shpejtë për të shkëputur grepin mbajtës në dorezë.



- 5 Vendosni kutinë e kapsulës për pastrimin e shpejtë në kapsulën për pastrimin e shpejtë.




- 6 Vendosni pjesën e sipërme të kapsulës për pastrimin e shpejtë përsëri në bazë dhe rrotullojeni drejtim të akrepave të orës deri sa të dëgjoni një klik.



Për të shmangur rrjedhjet mos e anoni kapsulën për pastrimin e shpejtë.

Përdorimi i kapsulës për pastrimin e shpejtë

Shënim: Nëse përdorni makinën e rrojës me shumë ose xhel rroje apo me produkte para rroje, shpëlajini mirë kokat e rrojës përpara se të përdorni kapsulën për pastrimin e shpejtë.



Shkunderni gjithmonë ujin e tepërt nga makina e rrojës para se ta vendosni atë në kapsulën për pastrimin e shpejtë.

- 1 Vendoseni makinën e rrojës përmbys në kapsulën për pastrimin e shpejtë. Ndërsa është e ndezur, makina e rrojës e dikton automatikisht që ndodhet në kapsulën për pastrim të shpejtë.
- 2 Ndizni makinën e rrojës për të nisur programin e pastrimit.
Çdo program pastrimi zgjat mesatarisht një minutë. Gjatë programit të pastrimit, koha e mbetur shfaqet si orë me numërim mbrapsht në dorezë.
- 3 Lëreni makinën e rrojës që të thahet plotësisht para se ta vendosni atë në kapsulën për pastrimin e shpejtë.

Çfarë kuptimi ka ikona në kapsulën për pastrim të shpejtë?

Ikona Sjellja

Kuptimi



Bëhet e dukshme në kapsulën për pastrim të shpejtë

Kutia e kapsulës për pastrim të shpejtë duhet të ndërrohet.



Ndërrimi i kutisë së kapsulës për pastrimin e shpejtë


Ndërroni kutinë e kapsulës për pastrimin e shpejtë menjëherë kur ikona për ndërrimin e kutisë në kapsulën për pastrimin e shpejtë bëhet e dukshme ose ndiqni tabelën e mëposhtme.

Shpeshtësia e përdorimit


Ciklet

Kur të ndërroni kutinë e kapsulës së pastrimit të shpejtë

Çdo ditë	Rreth 30	Çdo muaj
Disa herë në javë	Rreth 20	Çdo 2 muaj
Çdo javë	Rreth 13	Çdo 3 muaj
Çdo muaj	Rreth 3	Çdo 3 muaj



- 1 Rrotulloni dhe hiqni pjesën e sipërme të kapsulës për pastrim të shpejtë.



- 2 Nxirreni kutinë e kapsulës për pastrimin e shpejtë nga kapsula për pastrimin e shpejtë me anë të dorezës.



- 3 Derdhini lëngjet e mbetura në lavaman dhe ricikloni kutinë e zbrazur në përputhje me rregulloret vendore për mbetjet.



- 4 Vendosni një kuti të re të kapsulës për pastrimin e shpejtë në kapsulën për pastrimin e shpejtë. Skanoni kodin QR në të majtë ose vizitoni **www.philips.com/cleaning-cartridge** për të porositur kuti të kapsulave për pastrimin e shpejtë.

Mbajtja

Shënim: Këshillojmë ta lini pajisjen dhe pjesët e saj të thahen përpara se t'i ruani për përdorim të mëvonshëm.

- Ruajeni pajisjen në çantë (nëse ka).
- Vendosni kapakun mbrojtës (nëse ka) në makinën e rrojës për ta mbrojtur atë nga grumbullimi i papastërtive.
- Përndryshe, vendoseni pajisjen në bazën e karikimit (nëse ka) ose në kapsulën për pastrim të shpejtë Philips (nëse ka).

Si mund t'i ndërroj kokat e rrojës?

Për performancë maksimale rroje, ju këshillojmë t'i ndërroni çdo dy vjet kokat e rrojës.

Ndërrojini menjëherë kokat e dëmtuara të rrojës.


Ndërrojini gjithmonë kokat e rrojës me koka rroje origjinale "Philips".

Ndërrimi i kokave të rrojës


- 1 Fikeni makinën e rrojës.
- 2 Shtypni butonin e lëshimit në njësinë e rrojës dhe hiqni mbajtësen e kokës së rrojës nga njësia e rrojës.



- 3 Rrotulloni unazat fiksuese në drejtim të kundërt të akrepave të orës dhe hiqini ato. Vendosini në një vend të sigurt.




- 4 Hiqini kokat e rrojës nga mbajtësja e kokave të rrojës. Hidhini menjëherë kokat e përdorura të rrojës për të shmangur ngatërrimin e tyre me kokat e reja.




- 5 Vendosni koka të reja rroje te mbajtësja.






- 6 Vendosni përsëri unazat fiksuese te kokat e rrojës dhe rrotullojini në drejtim të akrepave të orës për të rivendosur unazën fiksuese.



- Çdo unazë fiksuese ka dy kanale që puthiten saktësisht me pjesët e dala të mbajtësit të kokës së rrojës. Rrotulloni unazën në drejtimin orar deri sa të dëgjoni një klik që tregon se unaza u fiksua.



- 7 Futni kapësen e mbajtëses së kokës së rrojës në pjesën e sipërme të njësisë së rrojës dhe mbylleni atë.

Porositja e aksesorëve

Për të blerë aksesorë ose pjesë këmbimi, vizitoni **www.philips.com/parts-and-accessories** ose drejtojuni shitësit tuaj për "Philips". Mund dhe të kontaktoni qendrën e kujdesit për klientin të "Philips" në vendin tuaj (shikoni fletëpalosjen e garancisë ndërkombëtare për të dhënat e kontaktit).

Disponohen aksesorët dhe pjesët e këmbimit si më poshtë:

- Kokat e rrojës Philips SH91
- Kapsula e pastrimit CC12, 2 paketa
- Kapsula e pastrimit CC13, 3 paketa
- Kapsula e pastrimit CC16, 6 paketa

Shënim: Disponueshmëria e aksesorëve mund të ndryshojë në varësi të shtetit.

Diagnostikimi

Ky kapitull përmbledh problemet më të shpeshta që mund të hasni me pajisjen. Nëse nuk keni mundësi ta

zgjidhni problemin me informacionin më poshtë, vizitoni www.philips.com/support për një listë të pyetjeve të shpeshta ose kontaktoni qendrën e kujdesit për klientit për shtetin ku ndodheni.

Makinë rroje

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Nuk mund ta lidh makinën e rrojës.	Nuk keni shkarkuar aplikacionin.	Shkarkoni aplikacionin.
	Makina e rrojës dhe telefoni inteligjent nuk janë çiftuar ende.	Çiftoni makinën e rrojës me telefonin inteligjent duke ndjekur udhëzimet në aplikacion.
	Përpjekja e parë e çiftimit dështoi.	Shçiftoni makinën e rrojës dhe telefonin inteligjent dhe përpiquni t'i çiftoni sërish.
	Telefoni inteligjent nuk mund ta gjejë makinën e rrojës.	Sigurohuni që telefoni inteligjent ka Bluetooth 4.2 e lart.
		Sigurohuni që "Bluetooth" të jetë aktivizuar në telefonin inteligjent dhe që siguresa për udhëtim të jetë çaktivizuar në makinën e rrojës.
		Sigurohuni që telefoni inteligjent të jetë më pak se një metër larg makinës së rrojës për të aktivizuar lidhjen me Bluetooth.
		Sigurohuni që makina e rrojës të jetë e karikuar.
	Makina e rrojës dhe telefoni inteligjent janë çiftuar më parë. Keni shkëputur vetëm makinën e rrojës.	Shkoni te cilësimet e "Bluetooth" në telefonin inteligjent. Sigurohuni që edhe telefoni inteligjent të jetë shkëputur. Më pas provoni t'i çiftoni sërish.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Dua ta përdor makinën e rrojës pa aplikacionin.		Nuk është nevoja ta lidhni makinën e rrojës me telefonin inteligjent përpara çdo rruajtjeje. Makina e rrojës funksionon mirë pa aplikacionin, megjithëse nuk do të keni të njëjtat përfitime. Për të marrë këshilla të personalizuar për rrojën, sigurohuni që ta lidhni të paktën çdo 20 rruajtje për të sinkronizuar të dhënat e rruajtjes.
Pajisja nuk punon kur shtyp butonin e ndezjes/fikjes.	Pajisja është ende në prizë. Për arsye sigurie, pajisja mund të përdoret vetëm pa kordon.	Hiqeni pajisjen nga priza dhe shtypni butonin e ndezjes/fikjes për ta ndezur atë.
	Bateria e rikarikueshme është shkarkuar.	Rikarikoni baterinë.
	Është aktivizuar siguresa për udhëtim.	Shtypni butonin e menysë për 3 sekonda për të çaktivizuar siguresën për udhëtim.
	Njësia e rrojës është ndotur ose dëmtuar aq sa motori nuk mund të punojë.	Pastroni mirë kokat e rrojës ose ndërrojin.
Pajisja nuk rruan aq mirë sa më parë.	Kokat e rrojës janë dëmtuar ose konsumuar.	Ndërroni kokat e rrojës.
	Qimet ose papastërtitë bllokojnë kokat e rrojës.	Pastroni mirë kokat e rrojës.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Rrjedh ujë nga pjesa fundore e pajisjes.	Gjatë pastrimit, mund të grumbullohet ujë midis pjesës së brendshme dhe kapakut të jashtëm të pajisjes.	Kjo është normale dhe jo e rrezikshme sepse të gjitha pjesët elektronike janë të mbyllura në një njësi elektrike të izoluar brenda pajisjes.

Kapsula për pastrim të shpejtë Philips

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Makina ime e rrojës nuk është e pastër pas përdorimit të kapsulës për pastrim të shpejtë Philips.	E hoqët makinën e rrojës përpara se të përfundonte programi i pastrimit.	Për programin e plotë të pastrimit, lëreni makinën e rrojës në kapsulën për pastrim të shpejtë Philips. Çdo program pastrimi zgjat rreth 1 minutë. Ikona e pastrimit fiket pasi përfundon programi i pastrimit.
	Kutia e kapsulës për pastrim të shpejtë Philips duhet të ndërrohet.	Ndërroni kutinë e kapsulës për pastrim të shpejtë Philips.
	Kapsula për pastrim të shpejtë Philips është e anuar.	Vendoseni kapsulën për pastrim të shpejtë Philips mbi një sipërfaqe të sheshtë.
Kapsula për pastrim të shpejtë Philips nuk ndizet.	Kapsula për pastrim të shpejtë Philips funksionon nëpërmjet motorit të makinës së rrojës.	Vendoseni makinën e rrojës në kapsulën për pastrim të shpejtë Philips. Ndizni makinën e rrojës.
	Makina e rrojës është e futur në prizë.	Shkëputeni makinën e rrojës nga ushqyesi.

Bateria e makinës së rrojës është shkarkuar.

Karikoni makinën e rrojës përpara se të përdorni kapsulën për pastrim të shpejtë Philips.

Kapsula për pastrim të shpejtë Philips është tejmbushur.

E përdorni rregullisht kapsulën për pastrim të shpejtë Philips pasi shpëlani makinën e rrojës por nuk e shkundni ujin e tepërt.

Shkundeni ujin e tepërt pasi të shpëlani kokat e rrojës çdo herë përpara se ta vendosni makinën e rrojës në kapsulën për pastrim të shpejtë Philips.

U rruat me xhelin ose shkumën e rrojës dhe nuk e shpëlatë makinën e rrojës përpara se të përdorni kapsulën për pastrim të shpejtë Philips.

Pastrojini mirë kokat e rrojës përpara se të përdorni kapsulën për pastrim të shpejtë Philips.

Udhëzime të mëtejshme

Për më shumë udhëzime dhe video për makinën e rrojës S9000, skanoni kodin QR më poshtë ose vizitoni **www.philips.com/myS9000shaver**



Riciklimi



- Ky simbol do të thotë që produktet elektrike dhe bateritë nuk duhet të hidhen me mbeturinat normale të shtëpisë.
- Zbatoni rregulloret e shtetit tuaj për grumbullimin e veçuar të produkteve elektrike dhe baterive.

Heqja e baterisë së karikueshme të integruar

Bateria e karikueshme e integruar duhet të hiqet vetëm nga një profesionist i kualifikuar kur pajisja hidhet. Përpara se të hiqni baterinë, sigurohuni që pajisja të jetë hequr nga priza dhe që bateria të jetë plotësisht e shkarkuar.

Merrni masat e nevojshme paraprake kur përdorni veglat për të hapur pajisjen dhe kur hidhni baterinë e rikarikueshme.

Kur administroni bateritë sigurohuni që duart tuaja, produkti dhe bateritë të jenë të thata.

Për të shmangur ndonjë qark të shkurtër të baterive pas heqjes, mos i lini kontaktet e baterive të takojnë me sende metalike (p.sh. monedha, karfica, unaza). Mos i mbështillni bateritë me fletë alumini. Mbrojuani kontaktet me ngjitëse ose vendosini bateritë në një qese plastike përpara se t'i hidhni.

- 1 Nëse është e mundur, hiqeni njësinë e rruajtjes ose prerjes nga pajisja.
- 2 Nëse ka vida në folenë e pajisjes, hiqini ato me një kaçavidë.
- 3 Hiqni panelet e jashtme duke futur një kaçavidë të sheshtë midis skajeve dhe duke e rrotulluar. Hiqni gjithashtu vidat dhe/ose pjesët shtesë dhe shkëputni çdo lidhje bashkuese.
- 4 Nëse ka një njësi energjie brenda pajisjes, hiqeni atë nga pajisja, prisni telat dhe hapni njësinë e energjisë me një kaçavidë.
- 5 Përkulni etiketat e baterive mënjane me një kaçavidë dhe hiqni baterinë e karikueshme.

Markat tregtare

"Apple", logoja e "Apple", "iPad", dhe "iPhone" janë marka tregtare të "Apple Inc.", regjistruar në SH.B.A. dhe vende të tjera. "App Store" është markë shërbimi e "Apple Inc."

"Android" është markë tregtare e "Google Inc." "Google Play" dhe logoja e "Google Play" janë marka tregtare të "Google Inc."

Fjala markë "The Bluetooth®" dhe logot janë marka tregtare të regjistruara në pronësi të "Bluetooth SIG, Inc." dhe çdo lloj përdorimi i markave të tilla nga "Philips Personal Care" është i licencuar.

© 2022 Koninklijke Philips N.V.
All rights reserved
3000.058.1984.1 (17/1/2022)



>75 % recycled paper
>75 % papier recyclé